

PROVINCA AUTONOME E BOLZANOS
ALTO ADIGE
INSTITUTI I PËRGJITHSHËM
NË GJUHËN ITALIANE
RRUGA MONTESSORI 3
39055 LAIVES
TEL: 0471/ 954423
FAX:0471/ 953502

Për të gjithë nxënësit dhe nxënëset
e shkollës fillore "M. Gandhi"
Për të gjithë prindërit
e shkollës fillore "M. Gandhi "

TITULLI: komunikim nga Drejtoria e Shkollës në lidhje
me mësimin në distancë.

Të dashur nxënës, nxënëse dhe prindër,

në këtë moment të vështirë dhe të ri për të gjithë,
është e domosdoshme që të ketë bashkëpunim midis
shkollës dhe familjes lidhur me zhvillimin e mësimin në
distancë.

Shkolla nëpërmjet regjistrimit elektronik, do të vendosi
disa detyra dhe veprimtari mësimore, pa i ngarkuar
tepër fëmijët. Të njëjtat veprimtari do të planifikohen
dhe hartohen duke patur parasysh që pa diskutim
mungojnë marrëdhëniet e përditshme me mësueset,
mësuesit dhe me grupin e shokëve dhe shoqeve.
Ne e konsiderojmë të përshtatshme shmangien e
transmetimit të thjeshtë të detyrave dhe ushtrimeve,

për këtë arsye ju ftojme të ndiqni udhëzimet e mësuesve tuaj, të cilët, nëpërmjet mësuesit kujdestar të klasës, do t'ju propozojnë, shpjegimet e veprimtarive mësimore që duhet të kryheni duke u kujdesur për nevojat e individualizuara dhe të personalizuara të trajnimit të secilit nxënës.

Në regjistrin elektronik, nën titullin “Materiali i mësimit”, do të vendosen një herë në javë disa veprimtari pune. Ato mund të jenë detyra/ushtime të ndryshme, tregues për “linkun” arsimore, tekste, sygjerime ...

Nëse dikush nuk është në gjendje të rikuperojë materialet, ai mund të kryejë veprimtari të tjera, si për shembull leximi i një libri, mbajtja e ditarit të këtyre ditëve, shikimi i një dokumentari në TV, shkrimi i përbërësve dhe përgatitja e një tortë me ndihmën e një të rrituri ...

Për ne është e rëndësishme, të mos japim afate të përshkruara për detyrat. Natyrisht kush e dëshiron atë dhe dëshironi të keni mendimin e mësuesit mund t'i kontaktoni ata nëpërmjet emailit institucional (emër.mbiemër@scuola.alto-adige.it).

Disa nga mësuesit tuaj po mbajnë kontakte joformale me ju, ndoshta nëpërmjet Whatsapp. Në këtë rast, ju kujtojmë se jeni duke pasur të dhënat personale, prandaj ju ftojme të ruani privatësinë e mësuesve (për shembull në rastin e audjove dhe vidjove, këto nuk mund të shpërndahen tek persona që nuk janë të autorizuar).

Të vetëdijshëm për përpjekjen e madhe që po përballlemi dhe sfidat e reja me të cilat përballlet

shkolla dhe familjet në të cilën ndodhen, besoj se aftësitë tona dixhitale, madje edhe në procesin e formimit, janë në gjëndje të sigurojnë të drejtën e arsimit dhe suksesin në shkollë.

Nëse keni vështirësi, probleme ose pyetje të veçanta për mësuesit ose shkollën tuaj dhe preferoni ti bëni ato në gjuhën tuaj, shkruajini në këtë adresë emaili Maria-Teresa.Mazza@scuola.alto-adige.it (mësuese Marilena) ato do të përkthehen në italisht për mësuesit tuaj ose për drejtorinë e shkollës.

Falenderoj gjithashtu, në emër të stafit mësimor, frymën bashkëpunuese dhe pjesëmarrjen e rëndësishme të familjeve.

Drejtoresha e shkollës
Prof. Germana Fiore